



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 8

Prishtinë, më 30.1.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Srdjan Mitrović, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Andin Hoti, Enver Hoti, Driton Çausi dhe Salih Salihu.

Munguan: Danush Ademi, Lutfi Zharku dhe Ganimete Musliu

Pjesëmarrësit tjerë : Ministrja Albena Reshitaj, Naser Ramadani-IKSHP, Ilir Morina-AMMK, Arben Xhukaj-KEK, Hilmi Jashari-Avokati i popullit, Arben Çitaku, Bedri Halimi, Muhamet Malesiu, Edmond Nulleshi.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Gjendja alarmante e ndotjes së ajrit dhe propozimet për ndryshimin e kësaj gjendje

Kryesuesi Daut Haradinaj, falënderoj të ftuarit nga institucionet kryesore për ndotjen e ajrit për pjesëmarrje, duke filluar nga ministrja Albena Reshitaj, Naser Ramadani, Ilir Morina, Arben Xhukaj, Hilmi Jashari etj, dhe në vazhdim kërkoj nga të pranishmit angazhimin maksimal për të paraqitur shkaqet kryesore pse është ndotja e ajrit në nivelin kaq të lartë në Kosovë, sidomos në Prishtinë, fakte këto që do të nevojiten edhe për mbledhjen plenare të caktuar për nesër enkas për këtë problematikë.

Ministrja **Albena Reshitaj** filloi elaborimin se kjo gjendje e krijuar me ajrin e ndotur nuk është ndonjë risi, ngase edhe më parë edhe tani veprohet sipas planit të veprimit e cila obligon të gjithëve bashkërisht, sidomos prioritet duke i dhënë ndotësve të mëdhenj siç është KEK etj, por edhe me veprime tjera MMPH është angazhuar bashkërisht me komunën, duke ndërmarr disa veprime parandaluese si për automjete ashtu edhe për lëndë tjera që ndikojnë në ndotjen e ajrit, por gjithnjë në suaza ligjore të lejuara, është krijuar Task Forca për të identifikua dhe krahasuar vlerat e krijuara negative. Ajo potencoi faktin se vetëm një shkaktar nuk është që shkakton ndotjen, ndaj vetëm me punë të përbashkët do të arrihet suksesi, nuk mjafton vetëm të mbrojtë veten secili këtu në këtë takim por të jemi fleksibil karshi popullatës dhe të mbrojmë atë. Duhet të kërkohej ndalimi i shitjes së thëngjillit nga kompanitë ilegale gjithnjë me një plan të përbashkët, potencoi ajo.

Iir Morina potencoi tejkalimet e ndotjes me grimcat PM 10 edhe PM 2.5, kurse AMMK ka pajisje për matjen e ndotjes të cilat bëhen çdo ditë për 24 orë, mirëpo rezultatet publikohen të nesërmen për shkak të mungesës të një soft weri i cili do të unifikonte të dhënat e stacioneve. Ai shtoi se kjo ndotje vjen edhe si rezultat i situatës meteorologjike, sidomos sidomos në kohën kur fillon dimri për shkak të krijimit të inversionit të ajrit, mjegullës dhe mungesës së erërave. Ndotja e ajrit 30% vjen nga termocentralet dhe industritë tjera, 30% nga automjetet dhe 30% vinë nga burimet që nuk janë gjatë verës dmth nga lëndët djegëse në familje, biznese etj, ndaj shpreson se kjo është kaluese sidomos me ndrrimin e kushteve meteorologjike, ngase edhe në disa qytete në rajon dominon gjendje e tillë e ndotjes së ajrit, bile Prishtina mbetet pas tyre.

Arben Xhukaj theksoi historikun e dy termocentraleve duke paraqitur tri problemet që kanë ekzistua më herët : tymtarët, hiri, fenoli dhe katrani, të cilat probleme (e treta) janë asgjësu, kurse deponia e hirit është mbulu ku janë mbjellë 260.000 fidane të drunjve. Transporti i hirit bëhet me standarde ndërkombëtare, filtrat në Kosovën A janë ndërruar më 2011, ndërkaq Kosova B mbetet ndotësi më i madh për shkak të mosndërrimit të filtrave që nga viti 1984. Grimcat e pluhurit në Prishtinë, vazhdoi, nuk janë të termocentraleve, ngase rrymat e ajrit nuk i sjellin ato në kryeqytet dhe se ato e kanë diametrin vetëm 3 km, kurse Prishtina është në largësi nga termocentrali 6 km. Filtrat për Kosovën B kushtojnë 74 milion euro, ndaj kjo është arsyeja e mosndërrimit të tyre, ngase KEK gjeneron mjete nga popullata përkatësisht nga pagesa e rrymës. Potencoi se Kosova deri tani nuk ka alternativ tjetër pos qymyrit i cili duhet të ceket se nuk ka sulfur agresiv dhe është me standarde të lejuara

Naser Ramadani sqaroi se IKSHP që nga viti 2009 ka njoftuar dhe senzibiluar opinionin dhe institucionet për ndotjen e ajrit kur edhe ka rekomanduar për masat që tani janë aktuale, grimcat e pluhurit shkaktojnë probleme shëndetësore respiratore-kardiovaskulare te popullata, tha, dhe masat që duhen ndërmarr janë ato që i përmendi ministrja, inspektorati duhet të mbikëqyr termocentralin Kosova B, kurse përdorimi i karburanteve për vetura të përdoret standardi Euro 4. Ai gjithashtu demantoi mediat se kinse është ngrit vizita apo kërkesat e popullatës nëpër spitale për shkak të ndotjes së ajrit ngase nëpër ambulanta zakonisht në këtë sezon rritet numri i pacientëve për shkak të gripeve dhe ndrrimit të klimës.

Salih Salihu u ndërlihd duke konstatuar se reagimi ynë vjenë vetëm kur ngulfatemi nga ndonjë problem, është për keqardhje mungesa e strategjisë afatgjate për gjendjen e ajrit apo mbrojtjen e tij, tha ai, gjithashtu shqetësuese konsideroi problemin e vajit (derivati ma i dobët i thëngjillit) që depërton nga veriu dhe i cili përdoret për ngrohje nga popullata bashkë me vajin e përdorur nga automjetet i cili përzihet dhe dhe i ipet popullatës për përdorim, përndryshe nuk u pajtua me masën e propozuar të ndalimit të veturave në periferi të kryeqytetit sepse nuk është zgjidhje (një tjetër deputet në hajgare tha : sepse gjenden arterjet tjera rrugore për të ardhur në kryeqytet), dhe kërkoi një strategji afatgjate të përdorimit të lëndëve djegëse, të heqet thëngjilli apo disi ndryshe. Ai uroi që mos të takohet komisioni prapë mbas një viti dhe të konstatoi gjendjen e keqe por të punohet më në fund ashtu si duhet.

Liburn Aliu pyeti për ndotjet që bëhen dhe kërkoi të dhëna të sakta sa janë ato , konkretisht nga Kosova B, potencoi çështjen e kualitetit të naftës nëpër shkollat e Prishtinës kur e ka ngrit këtë çështje komuna e Prishtinës, dhe propozoi kontrollimin e kualitetit të naftës së importuar, kompanit që grumbullojn vajrat e makinave si mund të janë të lirë për të shitur për lëndë djegëse, nuk u pajtua me ndaljen e veturave në periferi dhe propozoi që Qeveria të financoi unazën që është një zgjidhje e duhur për shkarkimin e automjeteve në qytet.

Avokati i popullit Hilmi Jashari theksoi se legjislacioni duhet të përkushtohet fillimisht zbatimit të ligjit pa marr parasysh çka flitet këtu, kurse ligji në këtë rast nuk zbatohet sidomos Neni 24 i Ligjit për mbrojtjen e ajrit, ky ligj gjithashtu nuk zbatohet tek masat ndëshkimore Neni 38 pa të cilat nuk ka pas dhe nuk do të ketë sukses në disiplinimin e akterëve kryesor të ndotjes. Ai shprehu habinë si mund të kemi pikërisht në këtë takim deklarime kontradiktore, ai thotë ashtu ky thotë kështu, kurse ndëshkimet dërgohen në kundërvajtje kur dihet se inspektorati sjell gjoba edhe në vendin e ngjarjes.

Daut Haradinaj falënderoj dhe ftoi deputetët nëse kanë pyetje. **Besa Gaxherri** aksentin kryesor e kishte se tani e tutje zbatuesit e ligjit duhet të marin përgjegjësit konkrete secili për punën e vet,

ngase si mund të arsyetohet ky shtet nëse ka persona që shesin vaj mbetje për ngrohje, a duhet dikush ti zbuloi këta njerëz, a është gjë e keqe për person për kësi lloj veprimi, automatet duhet të sanksionohen sipas vitit të prodhimit e jo të aplikohet masa e ndalimit të tyre, KEK të prodhoi por jo të shkaktoi sëmundje të ndryshme të rënda, pra të zbatohet ligji, ngrohja me koogjenerim të shtrihet edhe nëpër komuna tjera jo vetëm në Prishtinë, sidomos tani që nuk ka mazut.

Driton Çausi vazhdoi me konstatimin se alarmimi i sotëm për ajrin e ndotur është bërë pikërisht për shkak se çasja është më e mirë në informacion sidomos nga ambasada Amerikane etj, ai gjithashtu konstatoi mospërputhje të deklaramëve këtu sot, si mund të ndodhë kjo pyeti, ka plan veprimi kurse nuk preken filtrat, si mund të ndodhë kjo, thëngjilli dëmton kurse nuk ka propozime me çka të zëvendësohet-si mund të bëhet ky konstatim kështu, ndotja shkakton vrasjen më të lartë në vend të popullatës kurse masat parandaluese janë minimale, si mund të ndodhë kjo, për Kosovën e re vendoset me nguti, cilësia e naftës problematike, cilësia e djegësës etj etj.

Andin Hoti vërejtjet e tij i përmbloodhi në një kërkesë të vetme : dëshirojmë ajër të pastër, dhe i potencoi disa vërejtje shumë domethënëse në këtë takim ngase siç tha ai është bërë shumë vështirë të jetohet në Prishtinë për shkak të problemit të ndotjes alarmante të ajrit, përsëriti kërkesën e dëgjuar në këtë takim që të shtrihet ngrohja qendrore edhe në komunat tjera dhe të zëvendësohet thëngjilli me çka...

Enver Hoti përsëriti disa konstatime që u dëgjuan në këtë takim dhe potencoi ato të cilat ishin kontradiktore, sidomos ato të MMPH dhe KEK, informacioni kryesor ishte në këtë takim se ligji nuk zbatohet, çka ishte edhe konstatimi i avokatit të popullit, ndaj kërkoi mosmashttrimin e opinionit ngase nuk na bënë nder dhe duhet të jemi të gjithë bashkërisht real në konstatime. Konstatohet ashtu apo kështu p.sh. nuk ndotet Prishtina, pra Inspektorati të ndërhyj përfundimisht se a dominon në këtë vend informaliteti apo ligji, që do të thotë se “dhezjen kryesore duhet ta bëjë Inspektorati, gjë të cilin ai nuk e bënë” përfundoi ai.

Haxhi Abdyl deputet nga komisioni për shëndetësi, me profesion doktor, lavdëroi konstatimet e z. Naser Ramadani dhe parashtroi disa risi p.sh. të vehet gazi natyror në përdorim edhe në Kosovë, të vehen në qarkullim tramvajet për qarkullim të popullatës, të gjobiten ndotësit kronik etj por gjithnjë duke pasur parasysh ritjen e buxhetit sidomos të ministrisë së shëndetësisë, ngase 140 euro në vit për kokë banori në shëndetësi është barazi me përsëritjen e këtyre problemeve çdo vit radhazi.

Daut Haradinaj në vazhdim dha fjalën dy pjesëmarrësve nga shoqëria civile të cilët ishin në takim nga publiku, **Liridon Gashi** nga SEEF dhe **Zhivojin Qirkoviq** nga GIOR të cilët pasi treguan për faktet nga vijnë, sidomos për ngrohje, konstatuan dhe sugjeruan përafërsisht njësoj sikurse parafolësit në këtë takim. Kryesuesi përfundimisht ja dha fjalën edhe një herë **ministres së MMPH** e cila konstatoj se ishte një takim i frytshëm dhe dobiprues ngase poçes sakt definohen detyrat e secilit, padyshim se do të kemi punë të përbashkët më të frytshëm duke zbatuar parimin e sinqeritetit dhe obligimit moral, e jo vetëm të mbrohemi secili. Megjithate ajo pranoi se është dashur paraprakisht ti plotësoi disa kërkesa të inspektoratit, nga të cilët tani e tutje do të kërkoi përgjegjësi dhe llogari, gjithashtu falënderoi për sugjerime siç ishin zgjërimi i koogjenerimit, sensibilizimi i popullatës që ai i cili ka kushte mos të përdor thëngjillin dmth njëherë e përgjithmonë ta eliminojmë thëngjillin, çdo institucion për çdo kontratë të paguaj një përqindje për mjedisin (parim i BE), shërbimi informacionit të punoj edhe më me përkushtim.

Kryesuesi DAUT HARADINAJ edhe përkundër polemikës në mes **Enver Hotit** dhe **Sekretarit të MMPH** konstatoi që ishte një takim i frytshëm dhe falënderoj shumë pjesëmarrësit, sidomos për faktin se nesër mbahet mbledhja plenare pikërisht për këtë temë, ku me siguri anëtarët e këtij komisioni do të janë me aktivitet të theksuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Daut Haradinaj